



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1176/Prot.
28

Tiranë më 04.5.2023

VENDIM

Nr. 24, datë 04.05 2023

“Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20%, të planit mësimor të programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Manaxhim Turizëm”, në Fakultetin e Ekonomisë, të UT-së, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 9; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma f; si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Ekonomisë me shkresat nr. 396/5 prot., datë 20.04.2023 dhe nr. 396/8 prot., datë 03.05.2023, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 04.05.2023;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Ekonomisë për ndryshime deri në masën 20% në planin mësimor të programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Manaxhim Turizëm”, për vitin akademik 2023-2024.
2. Ky vendim i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha

